

# Përbledhje Jo- Teknike e VNM

Ndërtimi dhe  
funkcionimi i  
hidrocentralit HEC  
Grabova 1 në pellgun  
e Përroit të Grabovës

GR Albania, korrik 2020

## Tabela e Përbajtjes

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Përshkrimi i Projektit .....</b>	<b>3</b>
2.1	Përshkrim I mjedisit në zonën ku do zhvillohet aktiviteti .....	4
2.2	Zonat e mbrojtura , monumentet e natyrës dhe te kulturës.....	6
<b>3</b>	<b>Identifikimi I ndikimeve në mjedis.....</b>	<b>8</b>
3.1	Metodologjitet për vlerësimin e ndikimeve .....	8
3.2	Impaktet gjatë ndërtimit .....	9
3.2.1	Ndikimi në tokë .....	10
3.2.2	Peisazh.....	10
3.2.3	Ndikimi në ajër .....	11
3.2.4	Ndikimi në biodiversitet .....	11
3.2.5	Ndikimi në ujëra .....	12
3.2.6	Impakti Social .....	12
3.3	Impakti gjatë funksionimit .....	14
3.3.1	Tokë, Ajër Biodiversitet .....	14
3.3.2	Ndikimi në ujëra .....	14
3.3.3	Ndikimi në aspektin social dhe ekonomik .....	14
3.3.4	Ndikimi në Peisazh dhe në Trashëgiminë Kulturore .....	15
<b>4</b>	<b>Masat zbutëse të ndikimeve negative në mjedis.....</b>	<b>16</b>
4.1	Të përgjithshme.....	16
4.1.1	Masat e ndikimeve sociale .....	16
4.2	Plani i Monitorimit të Mjedisit .....	16
<b>5</b>	<b>Përfundime dhe Rekomandime.....</b>	<b>18</b>

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permbledhje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

## Listë e Figurave

Figura 1-1: Harta e projektit Grabova 1 .....	3
Figura 2-1 Habitat i përbërë nga pemë konifore të perzierë me dru gjetherënës.....	5
Figura 2-2: Harta me zonat e mbrojtura , monumetet e natyrës dhe distancat.....	7
Figura 3-1: Harta me zonat e banuara .....	12
Figura 3-2: Zona e banuar që mund të ndikohet nga projekti / Zona buferike.....	13
Figura 3-3: Harta e përdorimit të tokës.....	13

## Listë e Tabelave

Tabela 3-1: Klasifikimi i ndikimit.....	8
Tabela 3-2: Shkalla e rëndësise sipas kodit të ngjyrave .....	9
Tabela 3-3: Kohëzgjatja e impaktit .....	9

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

## 1 HYRJE

Subjekti "Grabova Hydropower" ka si synim zhvillimin e projektit për ndërtimin e hidrocentralit Grabova 1 me fuqi instaluese prej 14900 KW në përroin e Grabovës. Objekti i studimit në këtë raport është përroi i Grabovës dhe i Babunit, projekt i kompanisë zhvilluese "GRABOVA HYDROPOWER"sh.p.k.

Bazuar në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", GR ALBANIA (Studio Mjedisore e licensuar) e kontraktuar nga kompania "GRABOVA HYDROPOWER" ka aplikuar pranë Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis paraprak për projektin, bazuar në shtojcën II të ketij ligji, pika 3/ë.

Subjekti "GRABOVA HYDROPOWER" eshte pajisur me Deklarate Mjedisore Nr. 7162 Prot, date 03.09.2018, Vendimi 39.

Ne baze te Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" te ndryshuar, Neni 20, Pika 5 "Nese veprimtaria nuk fillon zbatimin ne terren brenda 2 vjeteve nga data e miratimit te vendimit per VNM-ne, atehere keto dokumente konsiderohen te pavlefshme dhe procesi i VNM-se fillo nga e para".

Duke respektuar Deklaraten Mjedisore dhe Ligjin e lartepermendur, subjekti i eshte drejtuar AKM-se me qellim informimi se "subjekti nuk ka filluar deri ne kete date procesin e ndertimit". AKM ne permjet shkreses Nr. 1987/1 Prot., Tirane 18.06.2020, shprehet se nuk e parashikon shtyrjen e afatit te vlefshmerise se Deklerates Mjedisore dhe ve ne vemendje se afati i vlefshmerise perfundon ne date 03.09.2020.

Qëllimi i këtij aplikimi është ndjekja e procedurës së njoftimit per organizimin e rikonsultimit me publikun si pjese e procedures per ri-aplikimin e Deklarates Mjedisore.

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-tekniqe e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

Projekti do të shtrihet pranë fshatrave: Kuratë, Lenie, Grabovë e Poshtme ,(nga veprat e marrjes deri në basenin e presionit) pjesë e njësisë administrative *Lenie*, ndërsa godina e hidrocentralit HEC GRABOVA 1 do të ndërtohet afër fshatit Bratila, njësia administrative *Kodovjat*, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.




Figura 1-1: Harta e projektit Grabova 1

Për realizimin e ndërtimit të hidrocentralit janë parashikuar ndertimi i objekteve: veprat e marrjes 1 dhe 2, tubacion, tunel, basen presioni dhe godina e hidrocentralit. Karakteristike për përroin e Grabovës është fakti se ai nuk ka një fillim të shënuar, por formohet nga kontributi i një mori të pafund burimesh, që dalin në pjesën e Sipërme të dy përrrenjve të mësipërm.

## 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Ndërtimi i veprave në rrjedhën e perroit te Grabovës do të fillojë pasi projekti të jetë pajisur me të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme. Metodat e ndërtimit, makineritë dhe lëndët e para do të jenë të njëjtë me punimet e zakonshme ndërtimore. Punimet e këtij projekti do të kryhen në terren tokësor dhe ujor . Për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të hidrocentraleve do të kryhen këto punime;

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

- Gërmim shkembi dhe dheu për veprat e marrjes, kanalet, tubacionin, tunel, basen presioni dhe godinë.
- Mbushje, njësjet me material të gërmuar të seleksionuar
- Hekur beton armim
- Beton per tunelin
- Mure dhe argjinatura
- Sistemim të shtratit të lumit
- Instalimi i tubacioneve
- Transport dheu

Punimet kryesore që do të zhvillohen në ketë projekt, renditen si me poshtë. Këto punime përfshijnë këto procese pune:

- Veprat e marrjes
- Kanali i reakordimit nga VM1 në dekantuesin 1
- Dekantuesi 1
- Kanali i derivacionit pa presion nga dekantuesi 1 në hyrje të tunelit
- Hapja e tunelit te derivacionit
- Baseni i presionit
- Tubacionet e rënies së turbinave
- Tubacioni i shkarkimit nga baseni

Kohëzgjatja e ndërtimit te veprës do të jetë 24 muaj (2 vite) nga data e marrjes së lejes së ndërtimit. Ndërsa funksionimi i hidrocentralit do të zgjasë për 35 vite.

## 2.1 Përshkrim I mjedisit në zonën ku do zhvillohet aktiviteti

Projekti Hec-Grabova 1, është projektuar të shfrytëzojë prurjet ujore të përroit të Grabovës (Rajoni i Gramshit), i cili derdhet në lumin e Devollit. Baseni ujëmbledhës i përroit të Grabovës është afërsisht  $78.50 \text{ km}^2$  i cili karakterizohet nga një territor malor në Shqipërinë qëndrore. Pellgu ujëmbledhës i përroit të Grabovës karakterizohet nga sipërfaqe pyjore të fragmentuara nga sipërfaqe të cilat shërbejnë si kullota për banorët e zonës, parcela të vogla bujqësore, joprodhuese, shkëmbore. Pellgu ujëmbledhës shquhet për një diversitet biologjik të pasur. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorë gjeologjikë, hidrologjikë, reliivi dhe mikroklima. Diversiteti i pasur i habitateve ofron një larmi të pasur

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

Ilojesh bimore, kryesisht të lartësive të larta malore. Karakteristike në këtë zonë mungon niveli i bimësisë të zonave të ulta, makiet tipike mesdhetare, por ndeshen pyje të përziera me konifores dhe dru gjetherënës.




Figura 2-1 Habitat i përbërë nga a) fomacion pyjor dhe b) pemë konifore të perzierë me dru gjetherënës

### Fauna


Fauna është shumë e pasur në lloje të ndryshme, si në llojet e zvarranikëve, amfibësh, gjitarë të vegjël e deri tek gjitarët e mëdhenj, shpendët e zogjtë. Ndër **gjitarët e mëdhej** (500m mbi nivelin e detit dhe më lart) përmendin dy grupe të rëndësishme barengrënsit si lepuri i egër (*Lepus europaeus*), derri egër (*Sus scrofa*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), ketri (*Sciurus vulgaris*), baldosa (*Meles meles*), etj. Grupi i mishngrënësve kryesore janë:, ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), zardafi (*Martes martes*), kunadhja (*Martes foina*), dhelpra (*Vulpes vulpes*), etj. **Shpendët** përbëjnë një tjetër klasë e rëndësishme e faunës së zonës, takohen shumë specie të rëndësishme, si: gjeli egër, kaliqyqes, qukapiku, skifteri, gjeraqina, thëllëza e malit, shkabat etj. **Llojet e zvarranikëve tokësore** që hasen në këtë zonë janë: zhapiku me tri vija (*Lacerta trilineata*), hardhuca ballkanike e mureve (*Podarcis taurica*), shigjeta e shkurtër (*Coluber gemonensis*), balla laramane balla e shtëpisë (*Elaphe longissima*), nëpërkë e malit (*Vipera ursinii*), nëpërkë).

**Fauna ujore** në përroin e Grabovës është e varfër për shkak të luhatjve të prurjeve ujore të tij. Në zona, në të cilat krijojen pellgje për një kohë të gjatë dhe me një nivel të qëndrueshëm të ujit ndeshen disa lloje amfibësh të të tillë si: bretkosa e zakonshme (*Rana balcanica*), Tritoni i rëndomtë (*Lissotriton vulgaris*), Tritoni me kreshtë (*Triturus cristatus*), Bretkosa barkëverdhë (*Bombina variegata*), Bretkosa greke (*Rana graeca*) dhe Bretkosa e kuqerremtë (*Rana temporaria*). Përroi i Grabovës, i cili karakterizohet nga prurje jo të qëndrueshme të ujit, dhe duke qënë një përrua malor (në afërsi të burimeve malore), është një habitat jo i përshtatshëm ujor për një diversitet të madh të peshqve.

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permbledhje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

## 2.2 Zonat e mbrojtura , monumentet e natyrës dhe te kulturës

Duke u bazuar në hartën e zonave të mbrojtua Maj 2016 e shpallur nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrotura, projekt i nuk do të ndikojë në zonat e mbrojtura , pasi do të zhvillohet larg tyre.



Zhvilluesi :	<b>GRABOVA HYDROPOWER</b>	Permblehdje jo-teknike e V/NM
Hartoi:	<b>GR ALBANIA</b>	Korrik, 2020




Figura 2-2: Harta me zonat e mbrojtura , monumentet e natyres dhe distancat

Zhvilluesi :		Raporti i Ndërveprimit me Mjedisin
Hartoi:		Prill 2018

### 3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ky seksion do të trajtojë ndikimet (negative dhe pozitive) në burimet fizike, ekologjike dhe mjedisin human gjatë periudhës së ndërtimit dhe funksionimit të projektit.

#### 3.1 Metodologjité për vlerësimin e ndikimeve

Metodologjia e aplikuar për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimit është planifikuar të marrë në konsideratë natyrën e ndryshme të ndikimeve bio-fizike, social-ekonomike dhe ndikimet kulturore. Karakteristikat kryesore të ndikimeve të mundshme që duhet të merren parasysh në përcaktim dhe vlerësimin e impaktit janë: madhësia, kohëzgjatja, kthyeshmeria dhe efekti kumulativ.

#### Metoda e vlerësimit së ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Tabela 3-1: Klasifikimi i ndikimit

Vlerësimi	Përvetësimi
<b>Rëndësia</b>	
Pa ndikim	Nuk egzistojnë ndikimet në mjedis.
Ndikim I papërfillshëm	Ndikimi në mjedis nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim të dukshëm në vlerën e tij dhe aktiviteti i propozuar do të ketë impakt shumë minimal, thuajse të pakonsiderueshëm në implementimin e tij.
Ndikim I ulët	Projekti ndikon pak në vlerat natyrore duke patur parasysh sasinë dhe cilësinë.
Ndikim mesatar	Vlerat mjedisore do të preken për shkak të shkallës së ndikimit dhe ndjeshmërisë. Ndryshimet janë të përkohshme dhe nuk do të ndikojnë negativisht në qëndrueshmërine e mjedisit. Duhet të shoqërohet njëkohësisht me masa kontrolluese dhe menaxhuese.
Ndikim I lartë	Ndodh kur aktiviteteti ka gjasa të përkeqësojë gjendjen e mjedisit duke cënuar karakteristikat e tij dhe elementet strukturore të vlerave mjedisore. Projekti shkakton ndryshim madhor në vlerat natyrore dhe habitatin e zonës, shpesh duke u shqëruar me ndikim të pakthyeshëm (efekti negativ do të vazhdojë në mjedis duke sjellë degradim). Rehabilitimi konsiderohet I vështirë në këtë fazë.
Kohëzgjatja e ndikimit	

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

Afatshkurtër	Parashikohet të zgjase vetëm për kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit.
Afatgjatë	Që do të vazhdojnë për gjithë jetën e Projektit, por pushon kur projekti ndalon operimin.
I përhershëm	Impakte të përhershme që shkaktojnë një ndryshim të përhershëm në receptorin ose burimin e prekur.
<b>Kthyeshmëria (Reversibiliteti)</b>	
I kthyeshëm	Gjasat që një parameter i matur mjedisor do të rikuperohet nga impakti mjedisor përmes teknikave të menaxhimit të mjedisit.
I pakthyeshëm	Dhe pse mund të meren masat rehabilituese, mjedisi nuk mund të kthehet sërisht në gjendjen e mëparshme.

Tabela 3-2: Shkalla e rëndësise sipas kodit të ngjyrave




Tabela 3-3: Kohëzgjatja e impaktit

Kohëzgjatja		
I Përkohshëm	Afatgjatë	I përhershëm
1	2	3

Ky vlerësim është mbështetur vetëm në disa nga kriteret e listuara më sipër dhe në vecoritë e mjedisit ku do të zhvillohet projekt. Mbi këtë vlerësim do të orientohen edhe masat që duhet të merren për të zbutur ndikimet, të cilat përbejnë dhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit.

### 3.2 Impaktet gjatë ndërtimit

Në mënyrë që të shprehim në mënyre të saktë impaktet specifike gjatë ndërtimit është e nevojshme të njihem me punimet kryesore që do të zhvillohen në ketë projekt. Këto punime përfshijnë proceset e punës si më poshtë sipas renditjes:

- Veprat e marrjes
- Kanali i reakordimit nga VM1 në dekantuesin 1
- Dekantuesi 1
- Kanali i derivacionit pa presion nga dekantuesi 1 në hyrje të tunelit
- Hapja e tunelit te derivacionit

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

- Baseni i presionit
- Tubacionet e rënies së turbinave
- Tubacioni i shkarkimit nga baseni
- Ndërtesa e HEC Grabova-1

### 3.2.1 Ndikimi në tokë

#### 3.2.1.1 Reliev

- Do të gërmohet materiali por do të rikthehet në fazën e rehabilitimit të terrenit.
- Do të shtrohet zhavor dhe do të bëhen punime të ndryshme si mur guri, betoni etj.
- Ndikimi i punimeve për ndertimin e veprave dhe përmasat e ndërhyrjeve do të jenë të ndjeshme, megjithatë këto volume gërmimi do të sistemohen në mjeshtësi e përcaktuara më të afërta për tu mbushur dhe më pas rehabilituar, me bimësi kryesishët të zonës (native). (*Impakt Mesatar, Afatgjatë, I kthyeshëm.*)

### 3.2.2 Peisazh

Faza ndërtimore do të konsistojë në ndërtimin e veprës së marrjes, kanalin e reakordimit, dekantuesi, baseni i presionit, tubacionet e rënies së turbinave, ndërtesa e hidrocentralit, punime rruore dhe lidhja me linjën e tensionit. Zbatimi i këtyre punimeve do të shoqërohet me ndryshime në peisazhin natyror të zonës. Ndryshimet të cilat ndodhin gjatë kësaj faze do të jenë ndikime afatgjatë pasi ato sjellin shndërrim të peisazhit ekzistues të zonës. Por, nisur nga vendndodhja e objektit, distanca nga qendrat e banuara vlerësojmë se këto ndryshime në peisazh nuk janë sinjifikante. (*Ndikim I ulët, Afatgjatë, I pakthyeshëm.*)

#### 3.2.2.1 Erozioni

Degradimi fizik dhe erozioni i tokës mund të jenë problem për shkak të terrenit. Proseset e punës gjatë ndërtimit si hapja e tunelit, kanali mund të krijojnë predispozita për formimin e procesit të erozionit.

Siqështë e shpjeguar edhe në studimin gjeologjik toka ku do të ndërtohet vepra eshtë e qëndrueshme dhe janë bërë illogaritjet e nevojshme që objektet dhe terreni ku ato do të ndërtohen të jenë po ashtu të qëndrueshme.

Në zonën që analizohet, projekt i propozuar nuk vlerësohet të ketë impakt negativ. Ndërhyrjet për ndërtimin e veprave do sistemojnë terrenin dhe do të shmangin fenomenin e erozionit. (*Ndikim I ulët, afatshkurtër, I kthyeshëm*)

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

### 3.2.3 Ndiçimi në ajër

#### 3.2.3.1 Gaze, pluhura

Gjatë ndërtimit do të ketë impakte në ajër, si pasojë e gjermimeve, punimeve mbushëse dhe ngjeshëse, hapja e tunelit, hapja e themeleve (godina e HEC). Do të ketë emëtime të (PM10, SOx, NOx, CO<sub>2</sub>) nga makineritë e rënda lëvizëse me diezel apo benzinë, paisjet ndihmëse portative, transportimi i materialeve dhe transporti punonjësve. Ky lloj ndikimi do të jetë i pranishëm në të ato segmente të përroit, në të cilat do të zhvillohen punime ndërtimore. Këto çlirime dhe ndikimet e tyre mund të konsiderohen të neglizhueshme, duke pasur parasysh kohëzgjatjen e kufizuar të fazës së ndërtimit, duhet të theksojmë që ky impakt është afatshkurtër. (*Ndikim i ulët, Afatshkurtër, i kthyeshëm.*)

#### 3.2.3.2 Zhurmat

Gjatë procesit të zbatimit të punimeve për ndërtimin e infrastrukturës së Hec-it, (hapjes së linjës së tubacionit, vendosjes së tubacioneve të turbinave, të ndërtimit të godinës së Hec-it, etj), mund të krijohen zhurma, por ato zgjasin vetëm gjatë fazës së ndërtimit të Hec-it dhe niveli i tyre nuk do t'i kalojë normat e lejuara, kështu që kjo nuk do të përbëjë problem për komunitetin. Kompania që do të ndërtojë dhe shfrytëzojë veprën hidroenergitike do të marrë në konsideratë ndikimin e zhurmave dhe do të marrë të gjitha masat për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative. (*Ndikim i ulët, Afatshkurtër, i kthyeshëm.*)

### 3.2.4 Ndiçimi në biodiversitet

#### 3.2.4.1 Flora

Për realizimin e projektit do të priten një sasi shkurresh dhe vegjetacioni natyror dhe pemë gjatë ndërtimit të nënobjekteve, traseve të tubacioneve të rënies së turbinave të Hec-it, dhe të godinës së Hec-it, tunelit etj. Këto janë kosto të pranueshme për projekte të tillë që kanë si qëllim prodhimin e energjisë elektrike me përfitim për ekonominë kombëtare dhe sidomos të popullsisë së rajonit ku do të ndërtohet Hec-i. Kompania investituese krahas zbatimit të projektit inxhinierik do të hartojë një plan rehabilitimi të zonës së projektit, veçanërisht aty ku toka i është nënshtruar punimeve të gjermimit, dhe mbushjes. (*Ndikim i ulët, Afatshkurtër, i kthyeshëm.*)

#### 3.2.4.2 Fauna

Gjatë fazës së ndërtimit të veprës së re Grabova 1, ngritja e pluhurit dhe shkaktimi i zhurmave ndikon në largimin e pjesshëm të gjallesave. Kafshët mund largohen vetëvetiu për shkak të zhurmave dhe vibrimeve momentale, por kjo nuk do të ndodhë gjatë shfrytëzimit të tij. Zbatimi i projektit dhe zhvillimi i tij nuk ndikojnë negativisht në humbjen dhe dëmtimin e

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

habitave si dhe të specieve shtazore në zonat ku do të ushtrohet aktiviteti. (*Ndikim i ulët, Afatgjatë, Pjesërisht i kthyeshëm.*)

### 3.2.5 Ndikimi në ujëra

(Ujëra sipërfaqësore dhe ujëra nëntokësore)

Nga zbatimi i këtij projekti ndikimet në ujëra do të janë prezente. Ndikimi në ujërat sipërfaqësore do të vijë si rrjedhojë e kryerjes së punimeve të ndërtimit të veprës së marrjes dhe dekantuesit, të cilat do të kryhen në shtratin e përrrenjve. Gjithashtu gjatë hapjes së trasesë së kanalit të derivacionit, mund të ketë edhe depërtim të materialit të gërmuar në shtratin e përroit dhe si rrjedhojë rritjen e lëndës së ngurtë në pezulli. Ndikim në ujërat nëntokësore nuk vlerësohet të ketë. (*Ndikim i ulët, Afatshkurtër, i kthyeshëm.*)

### 3.2.6 Impakti Social

Gjatë ndërtimit, në pjesën që do të kalojë projekti ne afërsi të fshatit Grabovë e Poshtme do të ketë impakt social, pasi kalon afër zonës së banuar. Kompania të kryejë procedurat e shpronësimit dhe kompensojë çdo banor të afektuar nga projekti, konform legjisacionit në fuqi. Ndërkohë punësimi i banorëve vendas konsiderohet si një ndikim pozitiv.




Figura 3-1: Harta me zonat e banuara

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-tekniqe e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020



Figura 3-2: Zona e banuar që mund të ndikohet nga projekti



Zona buferike

Rreth veprave është menduar një zonë punimesh me rreze ndikimi deri në 50m, ndërsa rreth objekteve gjatësore (kanal, tubacion, tunel) vlerësohet të jetë një rreze ndikimi deri në 25m. Duke iu referuar informacionit kadastral rreth 75% e tokës (në zonën e projektit) është tokështet. Në lidhje me hartën e përdorimit të tokës sikurse mund te verehet në harta si më poshtë , pjesa më e madhe e projektit do të kalojë në tokë me bimësi sklerofile (VM1, kanal derivacioni, tubacion turbinash) , një pjesë në zonë shkëmbore (tunel, godine centrali) , pyje të përziera (një pjesë tuneli dhe kanal).




Figura 3-3: Harta e përdorimit të tokës

Zhvilluesi :	 GRABOVA HYDROPOWER	Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:	 GR ALBANIA	Korrik, 2020

### 3.3 Impakti gjatë funksionimit

#### 3.3.1 Tokë, Ajër Biodiversitet

Gjatë funksionimit hidrocentrali Grabova 1, nuk vlerësohet të ketë impakte në tokë. Nuk do të ketë emëtime në ajër. Hydroenergja është energjia e përfshuar nga uji, i cili bën pjesë tek burimet e rinovueshme. Prodhimi i energjisë nga uji është konsideruar si energji e cila nuk emëton në mjeshtë. (*Ndikim I papërfillshëm.*)

Niveli I zhurmave do të jetë konstant, por I papërfillshëm. Regjimi gjatë zhfrytëzimit të HEC-it do të gjenerojë zhurma të cilat nuk përbëjnë shqetësim as për punonjësit e veprës. Zhurmat do të vijnë turbinat (të cilat janë brenda godinës së HEC), transformatori, etj. Vetë godina e HEC do të shërbejë si barrierë për minimizimin e zhurmës. (*I papërfillshëm, Afatgjatë, I kthyeshëm.*) Për periudhën e funksionimit të HEC-it janë studiuar ndikimet e mundshme në ekologji.

Fauna ujore do të ndikohet për shkak të ndikimit në regjimin hidrologjik të përroit. Kushtet ekologjike të përroit favorizoninë habitate të përshtatshme për ekzistencën e troftës. Projekti teknik parashikon ndërtimin e veprës së kalimit të peshkut (bypass), i cili do të jetë në varësi të reliefit dhe do të reduktojë ndikimin negativ mbi faunën ujore. Për këtë arsyen operimi i Hec-it në përroin e Grabovës do të ndikojë *Negativisht*, intesiteti i ndikimit do të jetë i *Vogël* (ky vlerësim është i bazuar në zbatimin e masës zbutëse, në kalimin e peshkut). Kohëzgjatja e ndikimit do të jetë prezent gjatë kohëzgjatjes së ndikimit *Afatmesëm*, dhe ky ndikim është plotësisht i *Kthyeshëm* pas përfundimit të projektit.

#### 3.3.2 Ndikimi në ujëra

Gjatë funksionimit të HEC-it do të ruhet prurja ekologjike e përroit, dhe gjatë periudhave të thatësisës nuk do të lejohet fuksionimi i Hec-it. Devijimi i rrjedhës të përroit do të shkaktojë ndikime në regjimin e përroit, në rrjedhën e poshtme (pas shkarkimit të ujrave nga përrroi i Grabovës në Lumin Devoll), duke reduktuar prurjen e aluvioneve. Duke qenë se shfrytëzimi i ujrave nga vepra hidroenergitike në periudha kritike do të jetë i kufizuar, kjo bën të mundur ruajtjen e ekuilibrit të basenit ujor. Gjatë funksionimit të HEC-it nuk pritet të ketë ndikime në cilësinë e ujit. (*Ndikim Negativ i vogël, Afatmesëm, I kthyeshëm.*)

#### 3.3.3 Ndikimi në aspektin social dhe ekonomik

Realizimi i projektit për ndërtimin i Hec-it nuk do të ketë ndikime në lëvizjen apo zhvendosjen e popullatës së zonës. Nga raporti i veprës si planvendosje me komunitetin bën që vepra të mos influencoje negativisht në çështjet sociale. Studimi dhe realizimi i tij ka si objektiv kryesor prodhimin e energjisë elektrike e cila do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit të zonës, duke ju krijuar mundësi punësimi, i cili mund të jetë sezonal (gjatë ndërtimit) ose i përhershëm (gjatë shfrytëzimit). Projekti do të krijojë mundësinë e

Zhvilluesi :		Permbledhje jo-teknike e VNM
Hartoi:		Korrik, 2020

punësimit të banorëve të zonës duke ndikuar direkt në rritjen ekonomike të tyre dhe indirekt në rritjen e ekonomisë së Bashkisë Gramsh. Me prodhimin e energjisë elektrike nga ky projekt, gjithashtu, do të ketë zhvillim edhe industria e lehtë si dhe do të zgjerohen edhe shërbimet. Ndërtimi i Hec-it shoqërohet me përmirësimin e infrastrukturës rrugore në afërsi të Hec-it. (*Impakt Mesatar pozitiv, Afatgjatë, I kthyeshëm.*)

### 3.3.4 Ndigimi në Peisazh dhe në Trashëgiminë Kulturore

Vlerësimi i ndikimeve të shkaktuara gjatë zbatimit dhe operimit të projektit në peisazhin e zonës mund të realizohet në menyre indirekte duke përcaktuar ndryshimet në parametrat e nivelit të ndërhyrjes në peisazhin e zonës, ndjeshmërinë vizuale, shumëlojshmëria e peisazhit, niveli i ndjeshmërisë dhe të vetisë së përshtatjes të peisazhit. Funksionimi i hidrocentralit nuk do të shoqërohet me ndikime shtesë në peisazh pasi ndryshimet do të vazhdojnë të jenë të njëjtë me ndryshimet e ndeshura në fazën e ndërtimit të veprave.

Zhvilluesi :		Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:		Korrik, 2020

## 4 MASAT ZBUTËSE TË NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

Masat zbutëse përfshijnë masa të përgjithshme, masa teknike, bioinxhinierike për minimizimin e impakteve negative. Do të trajtohen në mënyre të përgjithshme këto masa si në vijim:

### 4.1 Të përgjithshme

Këto masa duhet të synojnë:

- Rehabilitimin e sipërfaqeve që do të përdoren dhe ndikohen nga veprimtaria ndërtimore
- Sistemimin e masës inerte shkëmbore qe do të dalë nga hapja e tunelit dhe trasesë pér vendosjen e tubacionit.
- Kontrollin e erozionit
- Llogaritjen e prurjeve ekologjike dhe programin e lëshimit të këtij faktori përgjatë rrjedhjes ekzistuese.
- Shqyrtimin e mundësisë pér të ndërtuar vepër kalimi pér peshqit, (By-pass). Instalimi i turbinave 'fish friendly', ose i rrjetës metalike.

#### 4.1.1 Masat e ndikimeve sociale

Në fazën e ndërtimit të projektit ndikimet në komunitet lidhen me përdorimin e tokës dhe punësimin.

- a. Kompania do të kryejë procedurat e shpronësimit dhe kompensojë çdo banor të afektuar nga projekti, konform legjislacionit në fuqi (nëse ka).
- b. Kompania duhet të shyrtojë me prioritet punësimin e banorëve të zonës në fillim.
- c. Kompania të konsultohet me banorët dhe të marri mendimin e tyre pér pakënaqësitet apo kërkesat në lidhje me projektin.
- d. Kompania pas perfundimit të projektit dhe para largimit të saj të kthejë zonën në gjendjen e mëparshme.
- e. Kompania të aplikojë masa pér të shmangur dëmtimin e rrugës së fshatit si dhe të përmirësojë gjendjen e saj.

Zbatimi me korrektesi i këtyre masave do të bëjë të mundur minimizimin e impakteve mjedisore.

### 4.2 Plani i Monitorimit të Mjedisit

Në lidhje me monitorimin mjedisor kompania investitore pasi të marrë vendimin pér VNM nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, do të zbatojë kërkesat e vendimit pér periudhën e

Zhvilluesi :		Permbledhje jo-teknike e VNM
Hartoi:		Korrik, 2020

ndërtimit në mënyrë që të jetë konform me legjislacionin Shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Nga organet kompetente mbikqyrëse në kuadrin e mbajtjes nën kontroll të parametrave mjedisore si dhe të veprave të veçanta inxhinierike si vepra e marrjes së ujit, linjat e tubacionit nën presion, etj.

Edhe pse HEC-i do të zhvillohet në zonë jo të mbrojtur, nevojitet që të kryhet bashkëpunim me institucione të specializuara, për ruajtjen e parametrave hidroenergjitarë pa prishur ekuilibrat mjedisorë pasi kemi të bejmë me ndërtim dhe përdorim të resurseve hidrike.

Pas ndërtimit të Hec-it duhet të mbahet nën mbikqyrje rehabilitimi i zonave të prekura nga punimet. Monitorimi i ndikimit në mjedis duhet të kryhet nga inspektorë të specializuar për mbrojtjen e mjedisit, të kontrollit të ujrave, shërbimit pyjor, pushtetit vendor dhe qendror, Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, Agjensia Kombëtare dhe Drejtoria Rajonale e Mjedisit.

Zhvilluesi :		Permblehdje jo-teknike e VNM
Hartoi:		Korrik, 2020

## 5 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- 1 Projekti në fjalë përputhet me nismën e qeverisë për nxitjen e sektorit per prodhimin e energjisë elektrike, nëpërmjet ndërtimit te Hec-ve të cilët do të ndihmojnë në rritjen e potentialit hidroenergetik të Shqipërisë.
- 2 Toka ku do të ndertohet vepra është e qëndrueshme dhe janë bërë llogaritjet e nevojshme që objektet dhe terreni ku ato do të ndërtohen të jenë po ashtu të qëndrueshme.
- 3 Nga sasia e ujit të nevojshëm do të sigurohet nga përrroi I Grabovës, është marë parasysh prurja ekologjike (ambientale) e tij. Kjo prurje do të jetë e përhershme dhe në sezone të thata, do të lejohet edhe e gjithë rrjedha e ujit natyral në shtratin e perroit.
- 4 Ndërtimi i hidrocentraleve, përvèç synimit kryesor të prodhimit të energjisë elektrike, do të ndikojë pozitivisht dhe në realizimin e disa qëllimeve të tjera si:
  - Gjenerim i të ardhurave për buxhetin e administratës vendore.
  - Rritja e prodhimit të energjisë elektrike dhe zhvillimi ekonomik i zonës.
  - Përdorimi i energjisë së rrinovueshme dhe prodhimi i energjisë
  - Rrugët e aksesit janë përceptuar si ndikim pozitiv.
  - Ekonomitë lokale mund të ndikohen pozitivisht.
  - Punësimi është përceptuar si një ndikim pozitiv i projektit.
- 5 Stafi teknik do ti kushtojë rëndësi menaxhimit të mbetjeve në vendin e punës dhe të sigurojë asgjësimin e tyre konform legjislacionit Shqiptar. Nga zhvillimi i aktivitetit do të krijohen mbetje inerte nga ndërtimi i godinës së hidrocentralit, trasesë së derivacionit, etj.
- 6 Gjatë ndërtimit të Hec Grabova 1 dhe zhfytëzimit të tij, subjekti ndërtues, krahas problemeve te ngitura në këtë raport, sipas legjislacionit të paraqitur në këtë raport, në veçanti duhet t'i kushtojë rëndësi edhe faktorëve të mëposhtëm:
  - Të respektojë procedurat, normat, standartet dhe planifikimet e paraqitura në projekt gjatë realizimit të tij.
  - Me vënien e projektit në zbatim, të respektojë dhe të vendosë në zbatim programin e monitorimit, për të pasur vazhdimesh tregues mjedisor konform standardeve dhe normave si në aspektin cilësor ashtu edhe në atë sasior.
  - Të kontrollojë vazhdimesh ecurinë e treguesve mjedisore të rrjetit hidrik të përrenjve dhe linjave elektrike të trasmentimit.
  - Në rast të mosfunkcionimit të parametrave sipas standardeve normativave, apo ndërhyrjeve , të ndërpresë aktivitetin dhe të komunikojë instancat e pushtetit vendor deri në ato qëndrore për dëmtimet përkatëse.
  - Të ketë kontakte te qëndrueshme me komunitetin e zonës.
- 7 Gjatë kryerjes së aktiviteteve të HEC- it të zbatohet rregullorja e Sigurimit Teknik për punimet në proceset e ndërtimit-transportimit-prodhimit etj.